

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL
NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2022**

1. Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Qëllimi i shkrimit të tekstit është **shpjegimi apo informimi i lexuesit** për pasojat që shkakton drita blu e pajisjeve teknologjike siç janë: celulari, tableti dhe kompjuteri (dhe përgjigje tjera të sakta).*
2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka identifikuar nga teksti: *Drita blu shkakton plakje të lëkurës sepse qelizat e lëkurës janë shumë të brishta dhe pigmenti nis e shuhet si dhe shkakton çrregullime në organizëm me pasoja në mungesën e gjumit gjë që çon në çrregullimin e hormoneve dhe shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme/Shkakton plakje të lëkurës dhe çrregullime në organizëm (dhe përgjigje tjera të sakta).*
3. Është rrethuar numri 2: *shkak - pasojë – 1 pikë*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Melatonina luan një rol të rëndësishëm në rregullimin e orës biologjike dhe tek cilësia e gjumit.*
5. Nxënësi merr **2 pikë** nëse përveç sugjerimit të ekspertëve që: *duhet përdorur syze që filtrojnë dritën blu dhe mbrojnë sytë ka shkruar edhe sugjerimet e veta që i përshtaten kërkesës.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë njëren pjesë të detyrës.
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Gjon Zaveri)*
7. Është rrethuar numri 3: *e dëshpëruar – 1 pikë*
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Ndërgjegjja e heroit vuan se është i shtrënguar të ndjekë gjurmët e traditës, normat e së cilës, për sa i përket martesës janë regresive. Sipas tij martesa duhet të jetë një akt plotësisht i lirë/ Heroi vuan nga mentaliteti i shoqërisë/rrethi ku jeton (dhe përgjigje tjera të sakta).*
9. Është rrethuar numri 2: *humb vlerën – 1 pikë*
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Lufta për të vërtetën, personalitetin dhe dinjitetin e njeriut/ Lufta kundër së keqes, krimit dhe padrejtësive (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar:

Vepra letrare	Emri dhe mbiemri i autorit	Drejtimi letrar
<i>"Komedia hyjnore"</i>	Dante Aligieri	Humanizmi
<i>"Ana Karenina"</i>	Leon Tolstoi	Realizmi

12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *"Kush i pari bani"*, Esad Mekuli

13. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka përshkruar nga poezia njërën nga metaforat e përdorura p.sh. *përleshje e mbrëndëshme, pasqyrë e përpjekjeve, etj.* dhe ndonjë prej krahasimeve, si: *e verdhë si shafrani, të ashpra si lëvore, etj.*

Nxënësi merr **1 pikë** për saktësinë e njëres prej figurave letrare.

14. Gjithsej **3 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3: *vllaun tim, kurban mjerimi.*

B) Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka argumentuar: *Vargu në fjalë sjell të gjallë shkallën e lartë të vuajtjeve e sakrificave, mjerimin e paskajshëm të mërgimtarëve (dhe përgjigje tjera të sakta).*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar shkurtimisht se: *vargu paraqet sakrificën e mërgimtarëve.*

15. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka veçuar karakterin: *tragjiko- komik* dhe ka argumentuar se *Zylo Kamberi është personazh komik për shkak të paaftësisë për të perceptuar realitetin, kurse personazh tragjik sepse veprimet e tij priren nga qëllime të mbara/ Personazhi i shokut Zylo shquhet si tragjikomik nga verbëria e tij ndaj realitetit edhe pse pa të keq (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka veçuar karakterin e saktë të personazhit, apo ka argumentuar saktë karakterin e duhur..

16. Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 2: *shpendit dhe poetit*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar: *Poeti ndihet i ngjashëm me këtë shpend të lirë sepse të dy dinë të fluturojnë të lirë nëpër qiell, hapësirë e kaltërsi/ Poeti e*

shih albatrosin si simbol të tijin sepse ashtu siç tallen me shpendin, ashtu edhe poetin e përjashtojnë nga shoqëria dhe e nënvlerësojnë (dhe përgjigje të tjera të sakta).

17. Është rrethuar numri 1: *i përkushtohen çështjes së zgjimit kombëtar të popullit – 1 pikë*

18. Gjithsej **2 pikë:**

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Molierit*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Autori synon që ne të mos i shohim të metat njerëzore si një e keqe e pandreqshme, por t'i trajtojmë me tolerancë dhe të mundohemi t'i ndreqim te të tjerët dhe tek vetja (dhe përgjigje të tjera të sakta)..*

19. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar saktë fjalët: *pavijon, regjisor, dizenteri.*

20. Gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar nën A. *Jokalimtare;*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar nën B. *Kalimtare.*

21. Gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar shumësin: *mendime, qytete, fshatra*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shpjegon se këta emra me ndërrimin e numrit, ndërrojnë edhe gjininë/ kalojnë nga gjinia mashkullore në atë femërore.

22. Gjithsej **2 pikë:**

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1: *përmbyllëse*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar përgjigjen e saktë: *Fjalja ka lidhëzën përmbyllëse prandaj*

23. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: Fjalët - *fusha, mali e deti* dhe Funkcionin: *kryefjalë*

Nxënësi merr **1 pikë** për një të saktë të detyrës.

24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional

FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT <i>3 pikë</i>	GJUHA <i>3 pikë</i>	STILI <i>2 pikë</i>
<p>Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit.</p> <p><i>3 pikë</i></p>	<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.</p> <p><i>3 pikë</i></p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.</p> <p><i>2 pikë</i></p>
<p>Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit.</p> <p><i>2 pikë</i></p>	<p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit - përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore <p><i>2 pikë</i></p>	<p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.</p> <p><i>1 pikë</i></p>
<p>Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet.</p> <p><i>1 pikë</i></p>	<p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <p>dhe/apo</p>	<p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...</p> <p><i>0 pikë</i></p>
<p>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme.</p> <p><i>0 pikë</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - gabon në përdorimin e parafjalëve... <p><i>1 pikë</i></p>	
	<p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së</p>	

	<p>madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>	
--	--	--

25. Skema e vlerësimit të esesë:

Don Kishoti- M. de Servantes

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan Miguel de Servantes, roman parodik, Klasicizmi <i>(1 pikë)</i> - tregon për dyshen Don Kishot- Sanço Panço, të pandashëm, plotësojnë njëri-tjetrin; Don Kishoti priret nga dëshira për të kryer heroizma, ka ndjenja humane, synon drejtësinë por rron me iluzione e ëndrra për të kthyer pas rrotën e historisë; Sanço Panço me një mentalitet të ngushtë fshatar, instinktiv, iluzionist, etj. <i>(1 pikë)</i> - shkruan për shprehjen e cekur e cila d.m.th. të matesh me një armik abstrakt, shumë më të forte se sa vetja, i cili as nuk shfaqet e as nuk ka emër (dhe përgjigje të tjera të sakta) <i>(1 pikë)</i> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qasja origjinale/ kreative ndaj temës <i>(1 pikë)</i> - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës <i>(1 pikë)</i> - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës <i>(1 pikë)</i>

	- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) Gjithsej 4 pikë
--	--

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë	FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. 3 pikë</p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore 2 pikë <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <p>dhe/apo</p> <ul style="list-style-type: none"> - gabon në përdorimin e parafjalëve... 1 pikë <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në</p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. 2 pikë</p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. 1 pikë</p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... 0 pikë</p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) 2 pikë</p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). 0 pikë</p>

<p>përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>		
---	--	--

Skema e vlerësimit të esesë:

Ndikimi i mediave në talentin e të rinjve

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon për rolin e mediave dhe llojet <i>(1 pikë)</i> - shkruan se cila nga mediat frekuentohet më tepër dhe pse <i>(1 pikë)</i> - shkruan për mendimin e vet nëse mediat ndikojnë në talentin e të rinjve dhe në çfarë mënyre, përmes shembujve konkret <i>(1 pikë)</i> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qasja origjinale/ kreative ndaj temës <i>(1 pikë)</i> - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës <i>(1 pikë)</i> - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës <i>(1 pikë)</i> - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale <i>(1 pikë)</i> <p><i>Gjithsej 4 pikë</i></p>

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë	FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. 3 pikë</p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore 2 pikë <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura dhe/apo - gabon në përdorimin e parafjalëve... 1 pikë <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin</p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. 2 pikë</p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. 1 pikë</p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... 0 pikë</p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) 2 pikë</p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). 0 pikë</p>

<p>e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>		
---	--	--